

Cement Board

AQUAPANEL®

Sisteme për
aplikim të jashtëm

kNAUF | **USG**
— SYSTEMS —

Ndërtoni në fuqinë tonë



AQUAPANEL® *Cement*



Teknologjia e pllakave të çementos AQUAPANEL®, e zhvilluar nga Knauf USG Systems vendos standarde të reja për formën dhe konstruksionin e objekteve. Sistemi AQUAPANEL® Cement Board i ofron arkitektëve dhe përpunuesve një alternativë të sprovuar, me vlera të larta dhe më ekonomike krahasuar me p.sh. mënyrën e ndërtimit me tullë apo blloqe.

AQUAPANEL® Cement Board Outdoor gjen përdorimin e saj në forma të ndryshme të mureve të jashtme, tavaneve të jashtme, rinovimin e fasadave si dhe të gjitha llojeve të projekteve të veçanta në hapsira të jashtme - me kosto më të ulët.

AQUAPANEL® Cement Board është material ndërtimor me jetëgjatësi ekstreme, që ofron një sipërfaqe solide dhe të thatë, shumë të qëndrueshme ndaj ndikimit të kushteve atmosferike si era, shiu dhe bora. AQUAPANEL® Cement Board është një pllakë ideale mbajtëse e suvasë, për mure të jashtme në sistemet e fasadave të ventiluara apo me aplikim si veshje direkte. Me sistemet e AQUAPANEL® Cement Board, ju dispononi krahas aksesorëve të duhur, poashtu sistemet e suvave AQUAPANEL® për trajtim final të sipërfaqeve.

Përparësitë e AQUAPANEL® Cement Board Outdoor:

Konstruksione komplete të mureve të jashtme dhe veshje sipërfaqësore

- Një avantazh domethënës në fushën e teknologjisë së pllakave të çementos
- Qëndrueshmëri ndaj ujit - nuk ka ndryshime në formë nga ngopja dhe nuk thërmohet
- Rezistente ndaj lagështisë dhe ndik. atmosferike
- E qëndrueshme nga ndryshimet ngrirje-shkrirje
- Konstruksion stabil dhe jetëgjatë me çimento Portland
- Qëndrueshmëri ndaj përkuljes dhe goditjeve
- Material i sigurtë dhe higjienik
- Nuk digjet

përpunimit me vegla speciale të punës

- Aftësi përpunimi unike nëpërmjet prerjes dhe thyerjes për një montim të shpejtë dhe më të lehtë
- EasyEdge™ - brinjët gjat. dhe tërth. shumë të forta
- Si rezultat i teknikës së ndërtimit të thatë eliminohet koha e tharjes
- Kohë më e shkurtër pune e kërkuar, kosto më të vogla montimi në objekt

Një sistem i kompletuar

- I disponueshëm në dimensione të ndryshme
- Përputhshmëri me normat evropiane
- Shërbim dhe mbështetje e gjërë në të gjithë Evropën
- Sisteme të garantuara dhe komplete nga një prodhues

Eficient dhe ekonomik

- Eliminon metodat me kohëzgjatje të lartë të

Aquapanel pllaka

Board Outdoor



Sisteme për aplikim të jashtëm



Sistemet Knauf USG ju orientojnë

AQUAPANEL® Cement Board Outdoor është një sistem i garantuar, prodhuar nga Knauf USG Systems i cili ofron përparësi vendimtare për të gjitha llojet e objekteve. Knauf USG Systems u formua si një Joint Venture ndërmjet Knauf dhe USG, dy furnitorë udhëheqës të sistemeve dhe materialeve të ndërtimit për përdorim të brendshëm dhe të jashtëm.

Si furnitor udhëheqës i sistemeve të pllakave të çimentos në Evropë, Knauf USG System angazhohet për zhvillimin e mëtejshëm të produkteve të reja. AQUAPANEL® Cement Board përdoret tashmë në gjithë Evropën, dhe është pllaka e preferuar e çimentos nga profesionistët në ndërtimtarë, si pllakë për aplikim të jashtëm, brenda si dhe në dysheme.

Në këtë broshurë prezantohet hollësisht AQUAPANEL® Cement Board Outdoor, në mënyrë që ju, në aplikime të jashtme të arrini rezultate finale sa më të suksesshme.

Përmbajtja

Hyrje	2
Paleta e produkteve	4
Përpunimi dhe montimi	10
Sistemi i veshjes direkt	12
Sistemi i fasadës së ventiluar	14
Shtresa e suvasë	17
Trajtimi sipërfaqësorë	18
Sistemi i tavaneve	19
Qëndrueshmëria dhe konstruksioni	21
Mbrojtja nga lagështia	22
Mbrojtja nga zjarri	23
Detajet e konstruksionit	24
Bazat e llogaritjes	42
Të dhëna teknike dhe çertifikata	45
Benefitet e sistemit	46
Tekste të preventivit	47

Brinjët EasyEdge™ janë të mbështjellura me rrjetë, e cila është përdorur për përforcim ekstra në pllakën e çimentos. Brinjët EasyEdge™ mundësojnë një përpunim të fugave me stukon AQUAPANEL® Fugenspachtel - gri dhe shiritin fugëmbulues AQUAPANEL® Fugenband (10 cm) duke realizuar një konstruksion të qëndrueshëm.



Paleta e produkteve

Mur:

Aksesorë të provuar



Aksesorë

AQUAPANEL® Cement Board Outdoor

Pllakat e çimentos janë të përbëra nga një bërthamë prej çimentos Portland dhe agregateve ndihmëse, të mbështjella nga të dyja anët me rrjetë. Brinjët ballore janë të prera ndërsa ato gjatësore janë me cepa të përforcuara me EasyEdge™.

Trashësia: 12,5 mm
Gjërësia: 1200 mm
Gjatësia: 1200, 2400, 1250, 2500 mm
Pesha: ~16 kg/m²
Paketimi: varësisht nga dimensionimi i pllakës



AQUAPANEL® Vida Maxi SN 39 AQUAPANEL® Vida Maxi SN 25 AQUAPANEL® Vida Maxi SN 55

AQUAPANEL® Vida Maxi SN janë të zhvilluara posaçërisht për fiksimin e AQUAPANEL® Cement Board në konstruksionin druri dhe konstruksionin metalik me trashësi llamarine 0,6 deri 0,7 mm. Vidat kanë një shtresë kundër korrozionit në majën e saj, e cila e garanton një qëndrueshmëri nga korrozioni 500 orë në testimin me spërkatje me solucion kripe.

AQUAPANEL® Vida Maxi SN 39 është e përshtatshme për veshje e konstruksionit metalik me një apo dy shtresa pllake ose për veshje njështrësore në konstruksionin druri.

AQUAPANEL® Vida Maxi SN 25 është e përdorshme për veshje njështrësore të konstruksionit metalik.

AQUAPANEL® Vida Maxi SN 55 është e përshtatshme për veshje dyshtresore në konstruksionin druri ose treshtresore në konstruksionin metalik.

Konsumi: 15 copë/m², distanca e akseve të profileve vertikale 600/625 mm
Paketimi: AQUAPANEL® Vida Maxi SN 39: 500 copë/pako
AQUAPANEL® Vida Maxi SN 25: 1000 copë/pako
AQUAPANEL® Vida Maxi SN 55: 250 copë/pako
Vidat në rryp sipas kërkesës



AQUAPANEL® Vida Maxi SB 39 AQUAPANEL® Vida Maxi SB 25

AQUAPANEL® Vida Maxi SB janë të zhvilluara ekstra për fiksimin e AQUAPANEL® Cement Board Outdoor në konstruksionin metalik me trashësi llamarine 0,8 deri 2,00 mm. Vidat kanë një majë shpuese dhe një shtresë mbrojtëse speciale nga korrozioni, e cila garanton një qëndrueshmëri nga korrozioni deri

në 500 orë në testin me spërkatje me solucion kripe.

AQUAPANEL® Vida Maxi SB 39 me majë shpuese përshtatet për një fiksime të një apo dy shtresave të pllakës së çimentos.

AQUAPANEL® Vida Maxi SB 25 është ideale për fiksimin e veshjes njështrësore.

Konsumi: 15 copë/m², distanca e akseve të profileve vertikale 600/625 mm
Paketimi: AQUAPANEL® Vida Maxi SB 39: 250 copë/pako
AQUAPANEL® Vida Maxi SB 25: 250 copë/pako
Vidat në rryp sipas kërkesës



AQUAPANEL® Vida për Fasadë SN 40

AQUAPANEL® Vida për fasadë SN 40 janë zhvilluar ekstra për fiksimin e AQUAPANEL® Cement Board Outdoor në konstruksionin druri. Gjatësia e vidave prej 40 mm është e përcaktuar për veshje njështrësore.

Konsumi: 15 copë/m², distanca e akseve të profileve vertikale 600/625 mm
Paketimi: AQUAPANEL® Vida për fasadë SN 40: 250 copë/pako



AQUAPANEL® Stuko për Fuga - Gri

AQUAPANEL® Stuko për fuga - gri është një masë stukuese me bazë çimento për mbushjen dhe ngjitjen e shiritit fugëmbulues AQUAPANEL® Fugenband (10cm)

Konsumi: afërs. 0,7 kg/m²
Paketimi: 10 kg/thasë


të provuar



AQUAPANEL® Shirit fugëmbulues (10 cm)

AQUAPANEL® Shiriti fugëmbulues (10 cm) është një rretë xhami me një shtresë rezistente ndaj alkaljeve, për stukimin e fugave në ambiente të jashtme. Ajo fundoset në masën AQUAPANEL® stukon për fuga - gri.

Konsumi: ~2,1 m/m²
Paketimi: rruli 10 cm i gjërë, 50 m i gjatë



AQUAPANEL® Rretë/shirit armues

AQUAPANEL® Rretë/shirit armues (33 cm) është një rretë xhami me kuadrate më të gjëra. AQUAPANEL® Rrjeta armuese përdoret në ambiente

të jashtme për përforcimin e fugave, atëhere kur mbi llaçin armues dhe ngjitës do të realizohet ngjyrosja. Vendosen mbi AQUAPANEL® Stukon për fugat - gri

Konsumi: ~ 2,1m/m²
Paketimi: rruli 33 cm i gjërë, 50 m i gjatë



AQUAPANEL® Stuko për ngjitje dhe armim

Stuko për ngjitje dhe armim, me bazë çimentoje, e përforcuar me lëndë plastike, shërben si suva parësore mbi pllakat AQUAPANEL® Cement Board Outdoor.

Konsumi: ~7,8 kg/m²
trashësia min. e shtresës 5 mm
Paketimi: 25 kg/thasë



AQUAPANEL® Llaç Betocoat Acryl

AQUAPANEL® Llaçi Betocoat është një përzierje akrili-polimeri, i cili pas përzierjes me çimento portland, përdoret si llaç për armim.

Konsumi: Si llaç për armim, në përzierje me çimento Portland në raport volumesh 1:1, ~3,6 kg/m²(Betocoat) trashësia min. e shtresës 5 mm
Paketimi: 15 kg/kovë



AQUAPANEL® Rretë për jashtë

Rrjeta për jashtë Aquapanel është një rretë xhami me kuadrate të gjëra, rezistente ndaj alkaljeve, e cila përdoret për mbulimin e plotë të sipërfaqes së trajtuar me llaç armues dhe ngjitës në ambiente të jashtme.

Konsumi: 1,1 m²/m²
Paketimi: rruli 100 cm i gjërë, 50 m i gjatë.



AQUAPANEL® Paralyerje - exterior

AQUAPANEL® Paralyerje për exterior është një emulsion i lëngshëm i parapregaditur me pigment të bardhë për lyerjen e sipërfaqeve para trajtimit të mëtejshëm të sipërfaqes si p.sh. me suva sintetike-silikoni Aquapanel Silikon Kunstharzputz. Pas tharjes ka ngjyrë të bardhë dhe rregullon aftësinë thithëse të sipërfaqes.

Konsumi:

~100-150 g/m²

Paketimi:

15 kg/kovë



AQUAPANEL® Suva sintetike-silikoni e bardhë

AQUAPANEL® Suva sintetike-silikoni e bardhe është një suva sipërfaqësore e gatshme me një diametër granulati prej 2 mm për trajtimin e sipërfaqes pas laçit për armim dhe ngjitje, si dhe AQUAPANEL® paralyerjes. Vetë të mira ndaj ndikimit të ujit dhe i hapur ndaj difuzionit me $sd > 0,1$ m.

Konsumi:

3,1 kg/m²

Paketimi:

25 kg/kovë

Udhëzim: AQUAPANEL®

Suva sintetike-silikoni është e disponueshme vetëm në ngjyrë të bardhë.



AQUAPANEL® Suva Dispersive - e Bardhë

AQUAPANEL® Suva dispersive - e bardhë është një suva sipërfaqësore e gatshme me një diametër granulati 2 mm për trajtimin e sipërfaqes mbi AQUAPANEL® llaçin për armim dhe ngjitje, si dhe AQUAPANEL® paraly. Vetë të mira ndaj ndikimit të ujit dhe i hapur ndaj difuzionit me $sd > 0,5$ m.

Konsumi:

3,1 kg/m²

Paketimi:

25 kg/kovë

Udhëzim: AQUAPANEL® Suva

dispersive është e disponueshme vetëm në ngjyrë të bardhë



AQUAPANEL®Tyvek® StuccoWrap™ (për sistemet e veshjes direkte)

AQUAPANEL®Tyvek® StuccoWrap™ është një membranë speciale me fibra shumë të holla dhe me një strukturë të ashpër. Kjo membranë është barierë uji nga jashtë -brenda dhe avuj -difuzive nga brenda - jashtë. AQUAPANEL®Tyvek® StuccoWrap™ falë strukturës së saj është optimale për plotësimin e kërkesave të përcaktuara gjatë aplikimit të pllakës AQUAPANEL® Cement Board Outdoor në sistemet e veshjes direkte. Ajo vendoset direkt pas shtresës së pllakës.

Konsumi:

1,1 m²/m²

Paketimi:

rruli 150 cm i gjërë, 75 m i gjatë

të provuar

Tavani:

Aksesorë të provuar



AQUAPANEL® Cement Board Outdoor

Pllakë e çimentos me një bërthamë prej çimentos portland dhe agregate ndihmëse, e armuar nga të dyja anët me një rrjetë fibër xhami. Brinjët ballore janë të prera ndërsa brinjët gjatësore janë të përforuara me EasyEdge™.

Trashësia:

12,5 mm

Gjërësia:

1200

Gjatësia:

2400

Pesha:

~ 16 kg/m²

Paketimi:

30 copë/paletë



AQUAPANEL® Vida Maxi SN 39 AQUAPANEL® Vida Maxi SN 25 AQUAPANEL® Vida Maxi SN 55

AQUAPANEL® Vida Maxi SN janë zhvilluar posaçërisht për fiksimin e pllakave AQUAPANEL® Cement Board Outdoor në konstruksion metalik me trashësi llamarine 0,6 deri 0,7 mm. Vidat kanë në majë një shtresë të hollë speciale mbrojtëse nga korrozioni, e cila garanton qëndrueshmërinë prej 500 orësh në testin me spërkatje me solucion kripte.

AQUAPANEL® Vida Maxi SN 39 është e përshtatshme për fiksimin e një ose dy pllakave në konstruksion metalik dhe për veshjen njështrësore në konstruksion druri.

AQUAPANEL® Vida Maxi SN 25 është e përshtatshme për vendosjen e veshjes në konstruksion metalik.

AQUAPANEL® Vida Maxi SN 55 është e përshtatshme për veshjen dy-shtresore në konstruksion druri dhe tre-shtresore në konstruksion metalik.

Konsumi:

25 copë/m², distanca e akseve të profileve mbajtës 300/313,5 mm

Paketimi:

AQUAPANEL® Vida Maxi SN 39:

500 copë/pako

AQUAPANEL® Vida Maxi Maxi SN 25:

1000 copë/pako

AQUAPANEL® Vida Maxi SN 55:

250 copë/pako

Vida në rryp sipas kërkesës



AQUAPANEL® Vida Maxi SB 39 AQUAPANEL® Vida Maxi SB 25

AQUAPANEL® Vida Maxi SB janë zhvilluar posaçërisht për fiksimin e pllakës AQUAPANEL® Cement Board në konstruksion metalik me trashësi llamarine 0,8 deri 2,0 mm. Vidat kanë në majë një shtresë të hollë speciale mbrojtëse nga korrozioni, e cila garanton qëndrueshmërinë prej 500 orësh në testin me spërkatje me solucion kripte.

AQUAPANEL® Vida Maxi SB 39 me majë shpuese përshtatet për fiksimin njështrësor ose dyshtësor pllake gipsi.

AQUAPANEL® Vida Maxi SB 25 është ideale për fiksimin e një shtrese pllake gipsi.

Konsumi:

25 copë/m², distanca e akseve të profileve mbajtës 3000/312,5 mm

Paketimi:

AQUAPANEL® Vida Maxi SB 39:

250 copë/pako

AQUAPANEL® Vida Maxi SB 25:

250 copë/pako

Vida në rryp sipas kërkesës



AQUAPANEL® Vida për fasadë SN 40

AQUAPANEL® Vida për fasadë SN 40 janë prej çeliku special dhe janë zhvilluar posaçërisht për fiksimin e pllakës AQUAPANEL® Cement Board Outdoor në konstruksion druri. Gjatësia e vidës prej 40 mm është e përcaktuar për veshjen një shtresore.

Konsumi:

25 copë/m², distanca e akseve të profileve mbajtëse 300/312,5 mm

Paketimi:

AQUAPANEL® Vida për fasadë

SN 40:

250 copë/pako



AQUAPANEL® Stuko për Fuga - gri

AQUAPANEL® Stuko për fuga-gri është një masë stukuese me bazë çemento për mbushjen dhe ngjytjen e shiritit fugëmbulues AQUAPANEL® Fugenband (10cm)

Konsumi:

~ 0,7 kg/m²

Paketimi:

10 kg/thasë

Paleta e produkteve



AQUAPANEL® Shirit fugëmbulues (10 cm)

AQUAPANEL® Shirit fugëmbulues (10 cm) është një rrjetë fibër xhami me një shtresë rezistente ndaj alkaljeve për stukimin e fugave në ambiente të jashtme. Ajo fundoset në masën AQUAPANEL® stuko për fuga - gri.

Konsumi:

~ 2,1 m²

Paketimi:

rruli 10 cm i gjërë, 50 m i gjatë



AQUAPANEL® Paralyerje - enterier

AQUAPANEL® Paralyerje për enterier është një dispersion i lëngshëm pa solucione avulluese, për lyerjen e pllakës AQUAPANEL® Cement Board. Mundëson përmirsimin e aftësisë ngjitëse të bazamentit për lyerje në tërë sipërfaqen me AQUAPANEL® stuko dhe patinim, ngjyrë të bardhë.

Konsumi:

~ 40 - 60 g/m²

Paketimi:

15 kg/kovë

2,5 kg/kovë



AQUAPANEL® Stuko për fuga dhe patinim - e bardhë

AQUAPANEL® Stuko për fuga dhe patinim - e bardhë është një masë stukuese për stukimin e gjithë sipërfaqes së pllakës AQUAPANEL® Cement Board. Patinimi i sipërfaqes me vendosjen e AQUAPANEL® rrjetës për jashtë .

Konsumi:

~ 3,5 kg/m², trashësi shtrese 4 mm

Paketimi:

10 kg/thasë



AQUAPANEL® Rrjetë për jashtë

AQUAPANEL® Rrjetë për jashtë është një rrjetë xhami me kuadrate të gjëra, rezistente ndaj alkaljeve, e cila mbi të gjitha është parashikuar për mbulimin e plotë të sipërfaqes së trajtuar me stuko për fuga dhe patinim - e bardhë në ambiente të jashtme.

Konsumi:

1,1 m²/m²

Paketimi:

rruli 100 cm i gjërë, 50 m i gjatë


Pllaka ideale për *Suvatim*




Përpunimi dhe montimi

Transporti dhe magazinimi


AQUAPANEL® Cement Board Outdoor mbahet gjithnjë vertikalisht ose mund të përdoret transportuesi me rrota. Aplikoni transportin me pirun ose vinç kur është paketimi në paletë. T'i kushtohet vëmendje që gjatë uljes në tokë të pllakave të mos dëmtohen këndet dhe brinjët.



Sigurohuni për aftësinë mbajtëse të sipërfaqes. Një paletë AQUAPANEL® Cement Board Outdoor rëndon mbi dyshe me 870 kg (8,7 kN).




AQUAPANEL® Cement Board Outdoor pllakat duhet të ruhen deri në aplikim nga lagështia dhe kushtet atmosferike. Pllakat e njomura duhet që para montimit të shtrihen horizontalisht mbi një sipërfaqe të rrafshët dhe të thahen nga të dyja anët.




Montimi

Pllakat, para montimit duhet ti përshtaten kushteve klimaterike (temperaturës dhe lagështisë së ajrit). Temperatura e materialit dhe ambientit nuk duhet të jetë nën +5°C. Materialet për trajtim (paralyerje) dhe shtresat nuk duhet të përdoren nën +5°C.




Prerja

Formati i dëshiruar vizatohet me laps dhe vizore mbi pllakë. Përgjatë vijëve pllaka AQUAPANEL® Cement Board Outdoor pritet dhe grithet me thikë nga njëra anë, në mënyrë që rrjeta të ndahet. Pllaka thyhet përgjatë brinjës së prerë dhe pritet me thikë rrjeta në anën e pasme.




Brinjë të prera me sipërfaqe të lëmuar, si p.sh. për kënde të jashtme realizohen me sharrë dore cirkulare me thithje tymi. Rekomandohet përdorimi i sharrës me fletë të fortë metalike ose diamanti.



Hapjet për instalime


Hapjet për instalime (p.sh. për kablo ose tuba) priten me një sharrë të hollë speciale për vrima. Diametri i hapjes duhet të jetë 10 mm më i madh se ajo e tubit. Hapsira e ngelur mund të mbyllet me një rozetë ose me shirit izolues gome.



Udhëzues i montimit

Instalimi me vida


AQUAPANEL® Cement Board fiksohet në konstrukcion me AQUAPANEL® Vida Maxi. Mundësisht duhet të përdoren AQUAPANEL® Vida për fasadë për fiksimin e pllakës në konstrukcion druri. Vidat vidhosen fillimisht në mes të pllakës së çimentos, pastaj vidhosen fundet dhe fillimet e pllakës. Gjatë montimit pllakat e çimentos duhet të palohen mirë mbi konstrukcion.



Distanca ndërmjet vidave ≤ 250 mm.


Distanca nga skajet ≥ 15 mm.

Pikat standarde për fiksime janë të shënuara në pllakën e çimentos me kryqe të vogla.




Vidat nuk duhet të vidhosen më tepër se sa duhet.

Udhëzim: Të respektohet dim. i fugës ndërmjet pllakave prej 3 - 5 mm.





Nuk kërkohet para shpuarje



Mure të harkuara - dhe konstrukcione për fasada

AQUAPANEL® Cement Board është pllakë ideale, e përshtatshme për forma dhe mure të harkuara. Para montimit të pllakave ndërtimore të çimentos, u jepet forma në të thatë. Gjatë dhënies së formës krijohen plasaritje të vogla në sipërfaqen e pllakës, të cilat nuk paraqesin ndonjë humbje të fortësisë apo të funksionit. Konstrukcioni ku do të fiksohet pllaka e harkuar AQUAPANEL® Cement Board duhet ti përkojë formës së harkuar përkatëse. Për rreze të vogla është e këshillueshme vendosja e profileve ekstra vertikal apo mbajtës. Distanca nga akset e profileve vertikale apo mbajtës duhet të jetë maksimalisht 300/312,5 mm. Rrezet e harkimit të pllakës AQUAPANEL® Cement Board janë të mundshme në varësi nga gjerësia e pllakës deri në një rreze minimale të përcaktuar të konstrukcionit të përgjithshëm.



Rreze ≥ 3 m

Formati i pllakave

1200/2400/1250/2500 x 900 mm

Rreze ≥ 1 m


Formati i pllakave

1200/2400/1250/2500 x 300 mm

(Pllakat duhet të priten vetë)

Sistemi i veshjes direkte

Struktura e ndërtimit





Legjenda:

- 1 AQUAPANEL® Cement Board Outdoor
- 2 AQUAPANEL® Stuko fugëmbuluese - gri
- 3 AQUAPANEL® Shirit fugëmbulues - (10 cm)
- 4 AQUAPANEL® Llaç armues dhe ngjitës
- 5 AQUAPANEL® Rrjetë - jashtë
- 6 AQUAPANEL® Praimer - jashtë
- 7 AQUAPANEL® Suva sintetike silikon - jashtë - e bardhë ose AQUAPANEL® Suva dispersion - e bardhë
- 8 Knauf pllakë gipsi
- 9 Shtresë izoluese ndaj avullit
- 10 Konstruksioni metalik
- 11 Shtresë e izolimit termik
- 12 AQUAPANEL® Tyvek® StuccoWrap™


Montimi - sistemi i veshjes direkte

1. Ndërtimi i konstruksionit

Konstruksioni metalik ose nga druri duhet të jetë i ndërtuar konform kërkesave statike. Distanca nga akset e konstruksionit duhet të jetë maksimalisht 600/625 mm. Udhëzime të veçanta shiqo në fq. 21.




Mbulimi minimal i shtresave prej 10 cm është treguar me një shenjë në membranën AQUAPANEL® Tyvek® StuccoWrap™.




2. Vendosja e AQUAPANEL® Tyvek® StuccoWrap™

2.1 Gjatë aplikimit të shtresës AQUAPANEL® Tyvek® StuccoWrap™, e cila vendoset mbrapa pllakës së çimentos. Për vendosjen e saj fillohet nga fundi i murit, membranat duhet meodomos të mbulojnë njëra tjetrën në bashkimet e tyre. Të gjitha mbulimet horizontale dhe vertikale duhet të jenë minimalisht 10 cm të gjëra.




2.2 Membrana fiksohet me shirit ngjitës ose material ngjitës; më pas realizohet vendosja e pllakave AQUAPANEL® Cement Board Outdoor.



Udhëzues i montimit

3. Instalimi me vida



Pllakat AQUAPANEL® Cement Board Outdoor fiksohen me AQUAPANEL® Maxi vidat të përshtashme për konstruksion metalik ose druri. Mundësisht të përdoren AQUAPANEL® vida për fasadë për fiksimin e pllakës në konstruksion druri. Vidat fillimisht vendosen në mes të pllakës së çimentos, pastaj vendosen në fund dhe fillim të pllakës. Gjatë montimit pllakat e çimentos duhet të palohen mirë mbi konstruksion.



Distanca e vidave ≤ 250 mm.
Distanca nga këndet ≥ 15 mm.





Vidat nuk duhet të vidhosen më tepër se sa duhet.

4.2 Pllakat vendosen deri tek shpatulla dhe pragu i dritareve. Nuk lejohet të krijohen asnjë fugë e vazhdueshme. Kjo mund të shkaktoj plasaritje dhe izolim jo të mirë.




4. Vendosja e pllakave

4.1 Pllakat AQUAPANEL® Cement Board Outdoor montohen horizontalisht ndaj drejtim të konstruksionit. Ndërmjet pllakave duhet të lejohet një distancë 3 - 5 mm. Për këtë përdoret një distancues i përshtatshëm. Gjatë montimit të rendit vijues të pllakave duhet siguruar që fugat vertikale të zhvendosen minimalisht me një gjërësi sa distanca ndërmjet profileve vertikale.




5. Stukimi


5.1 Konstruksioni mbrohet nga kushtet atmosferike, duke mbushur të gjitha fugat me AQUAPANEL® stuko për fuga - gri.



5.2A AQUAPANEL® shiriti fugëmbulues (10 cm) duhet të vendoset menjëherë në mes të të gjithave fugave.



5.2B Në rast se mbi AQUAPANEL® llaçin armues dhe ngjitës do të aplikohet vetëm një shtresë ngjyre, në vend të AQUAPANEL® shiritit fugëmbulues (10 cm) përdoret AQUAPANEL® shiriti armues me një gjërësi 33 cm.




5.3 Kokat e vidave stukohen me AQUAPANEL® stuko për fuga - gri.



Udhëzimet për trajtimin përfundimtar të sipërfaqes mund ti merrni nga informacioni në faqe 17.

Sistemi i fasadës së ventiluar

Struktura e ndërtimit




Legjenda:

- 1 AQUAPANEL® Cement Board Outdoor
- 2 AQUAPANEL® Stuko për fuga - gri
- 3 AQUAPANEL® Shirit fugëmbulues (10 cm)
- 4 AQUAPANEL® Llaç armues dhe ngjites
- 5 AQUAPANEL® Primer - jashtë
- 6 AQUAPANEL® Suva sintetike - silikon - e bardhë ose AQUAPANEL® Suva dispersion - e bardhë
- 7 Profile mbajtëse
- 8 Profile kryesorë
- 9 Shtresë termo izoluese
- 10 Bazament me aftësi mbajtëse
- 11 Bazament me aftësi mbajtëse


Montimi - sistem i fasadës së ventiluar

1. Montimi me përdorimin e binarëve kryesorë.


1.1 Binarët kryesorë horizontalë fiksohen në mes me elemente të përshtatshme dhe në sasi të mjaftueshme. Binarët kryesorë duhet të kenë një seksion të prerjes të paktën 24 x 60 mm. Në mënyrë që të rritet izolimi termik i konstruksionit, hapsira ndërmjet binarëve kryesorë mund të mbushet me një material termoizolues të qëndrueshëm ndaj kushteve atmosferike.



1.2 Në kënde binarët kryesorë vidhosen duke mbuluar njëri-tjetrin.



1.3 Konstruksioni me binarë kryesorë duhet të bashkërendohet me hapjet e fasadës. Gjithmonë duhet të parashihen binarë shtesë kryesorë për sipër dhe poshtë hapjeve. Udhëzime të veçanta shiko në faqen 21.




Udhëz

2. Montimi i binarëve mbajtës


2.1 Pas fiksimit të binarëve kryesorë, montohen binarët mbajtës me distancë të akseve 600/625 mm. Për të siguruar hapsirë të mjaftueshme gjatë bashkimeve të dy pllakave, përdoren binarë me seksion tërthor minimal 24 x 80 mm.



2.2 Reth hapjeve përdoren binarë mbajtës shtesë.




2.3 Në pikat e poshtme dhe të sipërme të konstruksionit montohet një profil për ajrosje, në mënyrë që të mbrojmë hapsirën e krijuar nga hyrja e keqbërësëve, insekteve dhe kafshëve të vogla.



3. Montimi i pllakave AQUAPANEL® Cement Board Outdoor

Instalimi me vida:






3.1 AQUAPANEL® Cement Board Outdoor fiksohen me AQUAPANEL® Vida Maxi. Mundësisht të përdoren AQUAPANEL® Vida për fasadë për fiksimin e pllakës në konstruksion druri. Vidat vidhosen në fillim në mes të pllakës së çimentos; më pas vidhosen fundet dhe fillimet e pllakës. Gjatë montimit pllakat e çimentos duhet të palohen mirë mbi konstruksion. Distanca e vidave ≤ 250 mm. Distanca nga cepat ≥ 15 mm.



Vidat nuk duhet të vidhosen më shumë se e nevojshme.



Vendosja e pllakave:

3.2 Pllakat AQUAPANEL® Cement Board Outdoor montohen horizontalisht ndaj shtrirjes së konstruksionit. Ndërmjet pllakave duhet të lejohet një distancë 3 - 5 mm. Për këtë përdoret një distancues i përshtatshëm. Gjatë montimit të rrjeshtit vijues të pllakave duhet të kihet kujdes, që fugat vertikale të zhvendosen minimalisht me një gjerësi sa distanca ndërmjet profileve vertikale.




ues i montimit

3.3 Pllakat vendosen deri tek shpatulla dhe parvazi i dritareve. Nuk lejohet të krijohet asnjë fugë e vazhdueshme. Kjo mund të shkaktojë plasaritje dhe izolim jo të mirë.




4. Stukimi


4.1 Konstruksioni mbrohet nga kushtet atmosferike, duke mbushur të gjitha fugat me AQUAPANEL® stuko për fuga - gri.



4.2 AQUAPANEL® shiriti fugëmbulues (10 cm) duhet të vendoset menjëherë në mes të të gjitha fugave.



4.2B Në rast se mbi AQUAPANEL® llaçin armues dhe ngjitës do të aplikohet vetëm një shtresë ngjyre, në vend të AQUAPANEL® shiritit fugëmbulues (10 cm) përdoret AQUAPANEL® shiriti armues me një gjerësi 33 cm



4.3 Kokat e vidave stukohen me AQUAPANEL® Stuko për fuga - gri.


Udhëzime për trajtimin përfundimtar të sipërfaqes mund ti merrni nga informacioni në faqe 17.



Shtresa e suvasë


AQUAPANEL® Cement Board Outdoor shërben në sistemin e paraqitur si pllakë mbajtëse e suvasë. Mbi pllakat AQUAPANEL® Cement Board Outdoor është i domosdoshëm, si për sistemin

Deri te kjo fazë pune, fugat janë mbushur me Aquapanel Stuko për fuga - gri dhe me AQUAPANEL® shirit fugëmbulues (10 cm). Kokat e vidave stukohen me AQUAPANEL® stuko për fuga - gri.




Përforcimi i këndeve

Këndet përforcohen, kur vendoset AQUAPANEL® Ilaç armues dhe ngjitës. Që këndet të mbrohen, vendoset një profil këndor mbi AQUAPANEL® Ilaçin armues dhe ngjitës.




Vetëm tek hapjet e dritares dhe derës.

Cepat e dritares përforcohen me AQUAPANEL® shirit rrjeta 50 x 30 cm (shiko ilustrimin).



Vendosja e shtresës armuese


Muri stukohet në të gjithë sipërfaqen me AQUAPANEL® Ilaç armues dhe ngjitës. Vendosja kryhet me dorë ose makineri (rekomandim për makinerinë: Pompë përzierse PFT G4 ose G5, rotor/stator D4-3, gjysëm rendiment, uji i nevojshëm 200 l/h)



me veshje direkte ashtu edhe për fasadën e ventiluar, trajtimi i sipërfaqes me një sistem suvaje. Për këtë përshtatet veçanërisht AQUAPANEL® sistemi i suvasë.


Shtrirja e rrjetës armuese

AQUAPANEL® Rrjeta - jashtë vendoset në të gjithë sipërfaqen, duke e futur brenda rrjetën në rreth një të tretën e llaçit armues. Trashësia e llaçit armues dhe ngjitës është 5 - 7 mm. Para hapave të tjerë të punës duhet të merret parasysh koha e tharjes prej 1 dite për çdo mm.




Lyerja e sipërfaqes me primer

AQUAPANEL® Primer - jashtë vendoset mbi AQUAPANEL® Ilaçin armues dhe ngjitës. Për suva me ngjyrë, mundet që AQUAPANEL® Primer - jashtë ti jepet ngjyra me pigmente të ngjashme me ngjyrën e suvasë. Koha nga lyerja me primer deri në vendosjen e suvasë duhet të jetë të paktën 24 orë derisa primeri të jetë tharë plotësisht.




Vendosja e suvasë

Mbi sipërfaqen e lyer me primer vendoset AQUAPANEL® suva dispersive - e bardhë ose AQUAPANEL® suva sintetike silikon - e bardhë me dorë ose me makineri (rekomandimi për makinerinë: pompë me FU, PFT-Swing ose -N2V). Përmbajtja e kovës duhet të përzihet plotësisht. Suvaja shtrihet sipas madhësisë së granulatit dhe në vijim strukturohet.



Trajtimi i sipërfaqeve





Sistem për aplikim të jashtëm me sipërfaqe të strukturuar

- 1 AQUAPANEL® Cement Board Outdoor
- 2 AQUAPANEL® Vida Maxi / AQUAPANEL® Vida për fasadë
- 3 AQUAPANEL® Shirit fugëmbulues (10 cm)
- 4 AQUAPANEL® Stuko për fuga - gri
- 5 AQUAPANEL® Llaç armues dhe ngjitës
- 6 AQUAPANEL® Rrjetë - për jashtë
- 7 AQUAPANEL® Praimer - për jashtë
- 8 AQUAPANEL® Suva sintetike silikon - e bardhë ose AQUAPANEL® Suva dispersion - e bardhë

AQUAPANEL® suva dispersion - e bardhë ose AQUAPANEL® suva sintetike silikon - e bardhë mund të ofrohen në ngjyra të ndryshme.


(Vlera e shkëlqimit të dritës: $H \geq 40\%$)



Sistem për aplikim të jashtëm me ngjyrosje

- 1 AQUAPANEL® Cement Board Outdoor
- 2 AQUAPANEL® Vida Maxi / AQUAPANEL® Vida për fasadë
- 3 AQUAPANEL® Shirit armues (33 cm)
- 4 AQUAPANEL® Stuko për fugat - gri
- 5 AQUAPANEL® Llaç ngjitës dhe armues me AQUAPANEL® Rrjetë-jashtë të vendosur mbi të
- 6 Sistem i ngjyrave

Udhëzim: Për informacione mbi sistemin e ngjyrave ju lutemi të përdorni këshillat dhe rregullat e prodhuesit. Për tonin e ngjyrës duhet të zgjidhet vlera e shkëlqimit të dritës $H \geq 40\%$.




Sistem për aplikim të jashtëm me klinker apo mbulesë qeramike

- 1 AQUAPANEL® Cement Board Outdoor
- 2 AQUAPANEL® Vida Maxi
- 3 AQUAPANEL® Shirit fuge (10 cm)
- 4 AQUAPANEL® Stuko për fugat - gri
- 5 AQUAPANEL® Llaç ngjitës dhe armues me AQUAPANEL® Rrjetë-jashtë të vendosur mbi të
- 6 Ngjitës fleksibël
- 7 Tullë dekorative

Ngjitja e mbulesës dekorative klinker apo qeramike duhet të jetë e rezistueshme ndaj ndryshimeve të temperaturës. Ngjitësi duhet të jetë i përshtatshëm dhe të zgjidhet në harmoni me prodhuesin e tullave klinker apo qeramike për sipërfaqen në bazë të çimentos. Peshë maksimale e lejuar e shtresave duke përfshirë sistemin e ngjitësit është 40kg/m^2 . Format i mbulesës është i kufizuar në një madhësi 33×33 (cm). Mbulesa me peshë dhe dimensione më të mëdha janë të mundshme sipas kërkesës.

Sistemi i tavaneve

Struktura e ndërtimit




Legjenda:


- 1 AQUAPANEL® Cement Board Outdoor
- 2 AQUAPANEL® Stuko për fuga - gri
- 3 AQUAPANEL® Shirit për fuga (10 cm)
- 4 AQUAPANEL® Stuko për fugat dhe sipërfaqen - e bardhë
- 5 AQUAPANEL® Rrjetë - jashtë
- 6 AQUAPANEL® Primer - brenda
- 7 Profil mbajtës
- 8 Profil kryesor

Montimi tavaneve


AQUAPANEL® Cement Board Outdoor montohet tërthorazi me profilet mbajtës, në mënyrë që të krijohet një fugë e zhvendosur me 90° nga profilet mbajtës. Pllakat e çimentos fiksohen në konstrukcion me 25 copë AQUAPANEL® Vida Maxi për m². Distanca e profileve mbajtëse është max. 300/312,5. Mundësisht të përdoren AQUAPANEL® Vida për fasadë për fiksimin e pllakës në konstrukcion druri. Vidat vidhosen në fillim në mes të pllakës së çimentos ; më pas vidhosen fundet dhe fillimet e pllakës. Gjatë montimit pllakat e çimentos duhet të palohen mirë mbi konstrukcion. Udhëzime të veçanta shiko në faqe 21.




Pllakat montohen me një fugë 3 - 5 mm në bashkim. Fugat e kryqëzuara nuk janë të lejueshme. Pas montimit të gjitha fugat mbushen me AQUAPANEL® stuko për fuga - gri dhe me AQUAPANEL® shirit fugëmbulues 10 cm të gjerë. Përveç kësaj stukohen të gjitha kokat e vidave.



Sipërfaqja lyhet me AQUAPANEL® Primer për jashtë. (primer / ujë 1:2).



AQUAPANEL® stuko për fuga dhe patinim - e bardhë vendoset me një trashësi prej 4 mm në të gjithë sipërfaqen. AQUAPANEL® rrjetë për jashtë futet brenda AQUAPANEL® stuko për fugë dhe patinim në rreth një të tretën e thellësisë.



Konstruksioni:

Varëset e konstruksionit të tavanit duhet të fiksohen në mënyrë të fortë dhe në rast se kërkohet të merren masa shtesë për tu siguruar ndaj përthyerjes. Fiksimi i varëseve në konstruksionin primar duhet të kryhet me një numër të mjaftueshëm elementesh fiksues të përshtatshëm. Këshillohet përdorimi i elementëve fiksues të lejuar nga inspektuesi i ndërtimit.

Fugat e dilatimit:

Konstruksioni i tavanit në rast nevojë duhet të paiset me fuga të dilatimit.

Fugat e dilatimit duhet të vendosen në distancë minimalisht në çdo 15m, kështu që një sipërfaqe pa paraqitjen e fugave ka dimensione max.

15m x 15m. Gjeometri të veçanta tavani, si p.sh. sipërfaqe me shumë thyerje, në raste të veçanta mund të kërkojnë fuga shtesë të dilatimit.

Qëndrueshmëria dhe konstruksioni

Qëndrueshmëria:

Krahës peshës vetjake, fasadat dhe tavanet, në ambiente të jashtme, në varësi nga lartësia e objektit dhe gjeometria e tij, ngarkohen përgjithësisht edhe nga ndikimi i erës. Konstruksioni duhet të përlogaritet me dimensionet dhe vlerat e prerjes tërthore të tij nën ndikimin e presionit të erës dhe tërheqjes së tij. Në raste të veçanta është e nevojshme të llogariten edhe ngarkesat e borës dhe akullit. Elementet e veçanta të konstruksionit duhet të testohen në funksionin e tyre teknik. Një dëshmi e efikasitetit të përdorimit kryhet nëpërmjet një kufizimi të deformimit prej max. $f=l/500$. Për testimin e elementit konstruktiv duhet të merren në konsideratë normat përkatëse dhe standardet.

Zgjedhja e materialit dhe mbrojtja nga korrozioni.

Fasadat dhe tavanet në ambientet e jashtme janë vazhdimisht në kontakt me kushtet e ndryshueshme klimatike. Materiali i duhur për konstruksionin zgjedhet në varësi të kërkesave për mbrojtjen nga lagështia. Krahës një konstruksioni druri janë në dispozicion edhe elementë konstruktivë metalikë. Elementeve konstruktivë metalikë u kushtohet vëmendje në mbrojtjen e mjaftueshme nga korrozioni. Për kombinime të materialeve të ndryshme duhet të testohet qëndrueshmëria e secilës. Për elementet e nënstrukturës me seksion të galvanizuar në të ftohtë dhe pjesët e bashkangjitura të stampuara referohuni EN 13964. Ngarkimi i secilës me lagështi dhe nga kjo rezulton klasa për mbrojtjen nga korrozioni të cilat duhet të përcaktohen nga specialistët e fushës.

Elementët varës, fiksues dhe bashkues:

Ndikimi në fasadë si pasojë e ngarkesës së erës, borës, dhe të tjera shpërndahet nëpërmjet konstruksionit dhe elementet e tij varës, fiksues dhe bashkues në konstruksionin mbajtës. Elementet e mësipërm konstruktivë plotësojnë funksionet si më poshtë.

Elementët varës:

Elementët konstruktivë të cilët ankorojnë mekanikisht konstruksionin në bazament.

Elementët fiksues:

Elementë konstruktivë metalik të cilët fiksojnë mekanikisht veshjen në konstruksion.

Element bashkues:


Element konstruktivë, të cilët lidhin konstruksionet ndërmjet tyre.

Ngarkesa të tjera në fasadë dhe tavan:


Ngarkesat e tjera, si p.sh. nga varja e reklamave, pllakatave ose strehave të diellit duhet të varen pavarësisht nga veshja prej AQUAPANEL® Cement Board në konstruksionin mbajtës primar. Ngarkesat të lehta si psh elementët dekorativë, korniza dhe ndriçimi mund të varen direkt me të paktën dy upa metalike në pllakën AQUAPANEL® Cement Board. Distanca e upave nga njëra tjetra duhet të jetë të paktën 75 mm. Për konstruksione të mureve madhësia e peshave të lehta është e kufizuar në max. 25 kg, ndërsa për konstruksionet e tavaneve është max. 10 kg. Në të dy rastet është menduar në pesha të vetme, jo sipërfaqore.

Pesha mbajtëse e upave (kg) e vetme dhe e ndarë


Trashësia e veshjes mm	Upa plastike Ø 8 oder Ø 10 mm	Upa metalike Vidë M5 ose M6
1 x 12,5	25 kg	30 kg
2 x 12,5	40 kg	50 kg



Upë metalike



Upë sustë



Upë me sustë palosëse

Mbrojtja nga lagështia

Mbrojtja nga lagështia me AQUAPANEL® Cement Board Outdoor

Lagështia është shkaku kryesor për dëmet në ndërtim.

Uji paraqitet në kantier si

- ujë i ndenjur dhe i rrjedhshëm
- ujë me kapilaritet
- ujë i ndenjur
- lagështi relative e lartë

Në shumë fusha ndërtimi, rezistenca nga lagështia dhe uji janë vendimtare për kualitetin dhe jetëgjatësinë e një objekti. Kërkesat e qëndrueshmërisë nga rreshjet duhen pasur parasysh sidomos tek konstruksioni i fasadave.

AQAUPANEL® Cement Board Outdoor është absolutisht i qëndrueshëm ndaj kushteve klimaterike si dhe ndaj të gjitha ndikimeve klimaterike të natyrës.

Gjithashtu pllaka AQAUPANEL® Cement Board Outdoor plotëson kërkesat e mëposhtme të mbrojtjes nga lagështia të një materiali të aplikueshëm për fasada:

- Qëndrueshmëri ndaj ujit dhe qëndrueshmëri e formës së materialit
 - Rezistent nga krijimi i mykut
 - Aftësi për të lejuar depërtimin e avullit të ujit për një klimë optimale
- AQAUPANEL® Cement Board Outdoor është pllakë ideale pikërisht për fusha të tilla, siç është vërtetuar edhe nëpërmjet provave dhe testeve të shumta:

AQAUPANEL® Cement Board Outdoor është në këtë mënyrë një pllakë ideale mbajtëse suvaje për aplikime të jashtme, siç është vërtetuar nëpërmjet provave dhe testeve të shumta.



Karakteristikat e rezistencës nga uji të AQUAPANEL® Cement Board Outdoor

Trashësia e materialit	Pesha	Dendësia në të thatë	Rezistenca nga difuzioni i avujve të ujit	S_d	Aftësia e transmetimit të nxehtësisë
12,5 mm	16 kg/m ²	1150 kg/m ³	$\mu = 19$	0,2375 m	0,36 W/mK

AQAUPANEL® Cement Board Outdoor është e qëndrueshme nga uji. Nën ndikimin e ujit pllaka AQAUPANEL® Cement Board ekspozon ndryshime jashtëzakonisht të vogla dhe të padëmshme për sistemin. Pllaka e çimentos nuk ndryshon as strukturën lidhëse as karakteristikat e saj statike.

AQAUPANEL® Cement Board Outdoor është rezistente ndaj zhvillimit të mykut dhe në këtë mënyrë është e përshtatshme për përdorim aty ku mund të llogaritet me lagështi të lartë, siç e konfirmon edhe Instituti i biologjisë ndërtimore në Rosenheim me raportin e tij Nr.3001-57. AQAUPANEL® Cement Board Outdoor shfaqet si një pllakë çimentoje me aftësi shumë të mira avull difuzuese me një rezistencë difuzioni $\mu = 19$. Me këtë është e sigurtë, që veshja nuk shfaq asnjë aftësi si barrierë e avujve, çfarë është shumë e rëndësishme për një veshje në fasadë optimale ashtu si e thekson Insituti për biologjinë ndërtimore në Rosenheim në raportin Nr.3001-56.



Mbrojtja nga lagështia

Mbrojtja nga zjarri

Mbrojtja e njerëzve dhe paisjeve nga zjarri është qëllimi kryesor i mbrojtjes nga zjarri

Mbrojtja parandaluese nga zjarri duhet të plotësojë kërkesat e mëposhtme konstruktive dhe planifikuese:

- Një rrezik më i vogël nga zjarri është atëherë, kur mundësisht aplikohen sa më shumë materiale jo të djegshme.
- Konstruksioni duhet të jetë i sigurtë, i cili në rast zjarri do të qëndrojë mjaftueshëm gjatë në këmbë dhe të pengojë përhapjen e zjarrit dhe tymit në ndërtesën tjetër ose pjesën tjetër të objektit.

Nga këto kërkesa rrjedh domosdoshmëria e kontrollit të sjelljes dhe mbrojtjes nga zjarri të materialeve të ndërtimit dhe elementeve strukturore dhe teknik. Çdo material ndërtimi klasifikohet sipas sjelljes së tij ndaj zjarrit. AQUAPANEL® Cement Board Outdoor klasifikohet si jo i djegshëm" Klasa A1 sipas EN 13501.

Me AQUAPANEL® Cement Board Outdoor krijohen konstruksione ndërtimi, sjellja e të cilave në rast zjarri është provuar nëpërmjet testimeve të shumta nga zjarri. Testimet e qëndrueshmërisë nga zjarri ndjekin standartet evropiane sipas EN 1364 për elementët jo konstruktiv dhe sipas EN 1365 për elementë konstruktivë mbajtës, si dhe mbështeten në EN 1363. Në kohën e njësimimit të normave evropiane,

rezultuan testime sipas normave nacionale, p.sh. sipas DIN 4102. Kjo broshurë gjithashtu përmban konstruksione, sjellja e të cilave ndaj zjarrit është provuar sipas DIN 4102.

Përgjithësisht, sipas rregullave evropiane të klasifikimit, mund të kryhet një klasifikim në hapat e 15/20/30/45/60/90/180/240 minutave.

Zgjatja e qëndrueshmërisë nga zjarri e konstruksioneve të testuara AQUAPANEL® arrin sipas çdo konstruksioni deri në maksimalisht nëntëdhjetë minuta dhe jepet për secilin element konstruktiv një klasifikim i saktë i qëndrueshmërisë nga zjarri. Duke bërë këtë, sipas emërtimit të klasifikimit njihet nëse është kryer testimi sipas normave Evropiane ose nacionale DIN. Për emërtimet internacionale përdoret shenja F si dhe për mure të jashtme jo mbajtëse shenja W. Emërtimi sipas normave evropiane përmbledhet nga shenja të shkurtëra të ndryshme. Shenjat e shkurtëra për përshkrimin e kriterëve të performancës janë treguar më poshtë me kuptimin e tyre.

Tabela e mëposhtme tregon renditjen e klasave të qëndrueshmërisë nga zjarri sipas DIN dhe EN.

Krahasoni i klasave të qëndrueshmërisë nga zjarri:

Renditja e klasave të aftësisë së qëndrueshmërisë të elementeve konstruktivë sipas DIN dhe EN

Emërtimi sipas organit mbikqyrës ndërtimor	Element konstruktiv mbajtës		Mure të brendshme jo mbajtëse	Mure të jashtme jombajtëse	Nëntavan i pavarur
	pa mbyllje ambienti	me mbyllje ambienti			
Frenues zjarri	R 30	REI 30	EI 30	E 30 (<i>i</i> → <i>o</i>) und EI 30 (<i>i</i> ← <i>o</i>)	EI 30 (a ↔ b)
	[F 30]	[F 30]	[F 30]	[W 30]	[F 30 nga të dyja drejtimet]
	R 60	REI 60	EI 60	E 60 (<i>i</i> → <i>o</i>) und EI 60 (<i>i</i> ← <i>o</i>)	EI 60 (a ↔ b)
	[F 60]	[F 60]	[F 60]	[W 60]	[F 60 nga të dyja drejtimet]
I qëndrueshëm nga zjarri*	R 90	REI 90	EI 90	E 90 (<i>i</i> → <i>o</i>) und EI 90 (<i>i</i> ← <i>o</i>)	EI 90 (a ↔ b)
	[F 90]	[F 90]	[F 90]	[W 90]	[F 90 nga të dyja drejtimet]
Zgjatja e rezistencës nga zjarri 120 min.	R 120	REI 120	-	-	-
Mur zjarri	[R 120]	[F 120]	-	-	-
	-	REI-M 90	EI-M 90	-	-

Testimet dhe klasifikimet mund të kryhen gjithashtu edhe vetëm nga njëra anë. Pavarësisht nga testi/testimet, të cilat kryhen, përshkruajmë klasat si më poshtë:

i → *o*, naq është arritur, të klasifikohet nga brenda në jashtë;

i ← *o*, naq është arritur, të klasifikohet nga jashtë në brenda;


i ↔ *o*, naq është arritur, të klasifikohen nga brenda në jashtë dhe nga jashtë në brenda.

Përshkrimi i aftësisë së rezistencës nga zjarri sipas Euronormës përshkruhet nëpërmjet kriterëve të mëposhtëm:


Prejardhja e shkurtesës	Kriteri
R (Résistance)	Aftësia mbajtëse
E (Étanchéité)	Mbyllje ambienti
I (Isolation)	Termoizolimi (nën ndikimin e zjarrit)
